



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.104/02-20613/21
Kaçanik: 30.07.2021

Në bazë të nenit 9 pika 1.8 të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2012 - MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur më 30 Korrik 2021, u;

INFORMUA

- 1.Me aktivitetin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021.
2. Në këtë raport janë cekur të gjitha takimet të cilat i ka mbajtur KKSB në gjashtë mujorin e parë të vitit 2021, në të cilat është biseduar për situatën e sigurisë në Komunën e Kaçanikut si dhe rekomandimet të cilat i kanë nxjerrë nga këto takime.
3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese është : “Raporti i punës së KKSB- së për 6 mujorin e parë të vitit 2021”/Lënda 01Nr.104/02-20613/21.

Me këtë shkresë njoftohen : Kryetari i Komunës, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendi
Kemal Mërseli



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	21/07-2021	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.		Numri	Shtojcë
	01	104/02-20613	-1.



Republika e Kosovës

Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-

01.Nr. zyrtar/ 2021

Raporti i punës së KKSBB –së për vitin 2021

Takimi i parë i KKSBB për vitin 2021 është mbajtur më **26 janar** të këtij viti, të cilin e ka udhëhequr Kryetari i Komunës ndërsa për gjendjen e sigurisë në komunën tonë ka raportuar Komandanti i Stacionit të Policisë, i cili raportoi mbi gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve si dhe ofroi një njoftim mbi sfidat dhe të arriturat për vitin 2020, dhe krahasuar me vitin paraprak u tha se ka pasur angazhim më të shtuar të Stacionit të Policisë për shkak të situatës me pandeminë.

Në këtë takim kryesisht është folur me situatën me pandeminë por edhe çështje tjera që prekin sigurinë qytetare.

Nga ky takim janë nxjerrë këto rekomandime:

- 1.Të rritet bashkëpunimi i akterëve të sigurisë dhe qytetarëve në parandalimin e dukurive negative,**
- 2.Institucionet e nivelit qendror të jenë më të përpiktë në dhënien e informacioneve për personat e infektuar me COVID-19,**
- 3.Të punohet më shumë rreth sinjalizimit të rrugëve,**
- 4.Të bisedohet me nivelin qendror për vendosjen e mburojave në rrugën magjistrale Kaçanik-Hani Elezit,**
- 5.KEDS të jenë më aktiv në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve në lidhje me rrjetin elektrik,**
- 6.Inspektorët komunal të jenë më aktiv në ruajtjen e sigurisë publike si dhe të asistojnë në parandalimin e ndërtimeve pa leje,**

7. Të zbatohet ligji për të gjithë ata që shkelin rregullat në trafik dhe për ata që nuk respektojnë masat e sigurisë të vendosura nga IKSHP,

8. Rekomandimet e dalura nga KKSBB për vitin 2020 të shqyrtohen dhe të punohet në zbatim të këtyre rekomandimeve.

Takimi i dytë i KKSBB është mbajtur më **15.03.2021** që është kryesuar nga Kryetari i Komunës dhe janë diskutuar tema të ndryshme që prekin sigurinë e qytetarëve . zv.Komandanti i Stacionit të Policisë z.Jaser Jaha i raportoi mbi gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve e që sipas tij ka ishte e qetë edhe pse sfida ishte situata me pandeminë që në këtë periudhë kohore kishte rritje të rasteve të infektuar me virus COVID19 .

Rreth situatës me pandemi Kryetari i Komunës dha një raport rreth aktivitetit të Këshillit Emergjent për menaxhimin e pandemisë dhe sipas këtij raporti anëtarët e KKSBB u njoftuan me situatën pandemie në komunën tonë e cila për momentin ishte e menaxhueshme, e që u apelua për një angazhim të gjithsecilit për mbajtjen nën kontroll të kësaj situate.

Rekomandimet e nxjerra nga ky takim ishin:

1.Të merren masa ndaj rrjeteve sociale që nxisin urrejtje,

2.Të rritet mobilizimi në ruajtjen e pyjeve,

3.Të angazhohet më shumë psikolog nëpër shkolla,

4.Të mbahen takime më të shpeshta të këshillit të prindërve, këshillit të nxënësve dhe arsimtarëve,

5.Të gjejmë forma ndërmjetësimi në zgjidhjen e problemeve eventuale,

6.Të gjinden forma bashkëpunimi në mes policisë dhe qytetarëve në parandalimin e dukurive devijante,

Më datë **19.05.2021** është mbajtur takimi i tretë të cilën e kryesoi Nënkryetari i Komunës, dhe pos temës aktuale mbi gjendjen e sigurisë dhe menaxhimi i situatës me pandeminë u trajtuan çështje tjera, e veçanërisht dukuria e prerjes ilegale të pyjeve e cila dukuri nga të pranishmit është vlerësuar si mjaft shqetësuese, dhe u apelua për një mobilizim më të madh si nga niveli lokal po edhe ai qendror në luftimin e kësaj dukurie.

Për situatën e sigurisë në përgjithësi në komunën tonë në periudhën në mes dy takimeve raportoi toger Skender Neziri i cili dha një raport lidhur me punën dhe sfidat që e preokupojnë stacionin e policisë në realizimin e planeve operative.

Rekomandimet e nxjerra nga ky takim ishin:

- 1. Përkushtim më i madh i institucioneve në mbrojtjen e pyjeve,**
- 2. Angazhim më i madh i institucioneve për siguri në parandalimin e dhunës në familje,**
- 3. Të gjenden forma bashkëpunimi me nivelin qendror në parandalimin e dukurive negative,**
- 4. Të hulumtohet dhe intervenohet në vendet që cenojnë sigurinë qytetare,**
- 5. Të angazhohemi në implementimin dhe realizimin e aktiviteteve në vetëdijesimin e të rinjve në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm,**

Pos takimeve të rregullta KKSB ka zhvilluar edhe aktivitete tjera siç ishin:

- Përfshirja e aktiviteteve që parandalojnë dukurinë e ekstremizmit të dhunshëm në Planin e Punës së KKSB,
- Roli i Bashkësisë Islame në parandalimin e ekstremizmit fetarë,
- Sesion informues me nxënës të shkollave të mesme me temë „Roli i institucioneve të sigurisë në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm”,
- Pjesëmarrës në këto ishin akterët e sigurisë në komunën tonë si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Këto aktivitete i kemi mbajtur në bashkëpunim me organizatën SDK(Sundimi i Demokracisë në Kosovë)

Për shkak të situatës me pandeminë në takimet tona nuk kemi pasur monitorim nga asnjë organizatë apo institucion që merret me monitorimin e punës së KKSB por që kanë marrë informacione çdo herë që ata kanë pasur nevojë .

Të gjitha takimet e mbajtura të KKSB gjithashtu janë publikuar në web. faqën e Komunës.

Kaçanik ,më 19.07.2021

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

